



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 02

Datë: 19. 01. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Florian Dushi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, krye shef.

ZRPPC: Valmira Selmani, drejtoreshë u.d., e ZRPPC.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së.

2. Aktivitetet e ZRPPC-së:

- Shqyrtimi i kërkesave të partive politike për shtyrjen e kuvendeve zgjedhore.

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të anëtarëve të Kuvendeve Komunale në: Viti dhe Deçan, Malishevë dhe Prizren.
- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i projektit: Dita globale e zgjedhjeve.
- Shqyrtimi dhe miratimi i projektit dhe agjendës për punëtorinë: Raport mbi implementimin e planit të punës së KQZ-së i vitit 2021, dhe hartimi i planit të punës së KQZ-se për vitin 2022.

Këshilli për Buxhet dhe Financa:

- Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për punëtorinë: Raporti mbi implementimin e planit të punës së KQZ-së i vitit 2021, dhe hartimi i planit të punës së KQZ-se për vitin 2022.
- Shqyrtimi dhe miratimi i planit përfundimtar i prokurimit për vitin 2022.
- Diskutim lidhur me vendimin e KQZ-së Nr.355/2021, të datës 30.01.2021, për pagesën e stafit të KQZ-së për rrezikshmërinë në punë nga pandemia COVID-19, lidhur me organizmin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

- **Këshilli i Personelit:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit ndryshimit të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2012, për emërimin dhe shkarkimin e KE/ZV/SKQZ, Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së dhe Zëdhënësit për Informim, adt.19.03.2012

Diskutim lidhur me pajisjen me ID-kartele VIP për anëtarët e KQZ-së.

4. Të ndryshme.

1.Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: E hapi mbledhjen e dytë të KQZ për vitin 2022, para vetës e keni rendin e ditës! A ka dikush ndonjë vërejtje, sugjerim etj.

Ilir Gashi: Në raportimin e këshillit personell, ka sjellë një propozim për plotësim-ndryshim të udhëzimit i cili, sic është thënë, është në kundërshtim me rregulloren e brendshme sa i përket shpalljes së konkurseve.

Alim Rama: Në këshillin për personell, ndërsa që nuk ka pasur harmonizim të akteve juridike, nëse dakordohemi me këtë, ne mund të diskutojmë. Ndoshta, në mungesë të kryesuesit, unë e kam udhëhequr KOZ. Ne, kemi shqyrtuar ditën globale të zgjedhjeve, por nuk është trajtuar punëtorja...

Kreshnik Radoniq: Unë, po propozoj që mbas kësaj me e mbajte një mbledhje vetëm as i përket personelit.. Më mirë të trajtohet kjo çështje, edhe një herë në personel, dhe menjëherë e kishim trajtuar në KQZ.

Në ndërkohë, miratohet rendi i ditës.

2. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi i kërkesave të partive politike për shtyrjen e kuvendeve zgjedhore:

Valmira Selmani, u.d, ZRPP: Zyra ka shqyrtuar kërkesat e subjekteve për shtyrjen e afateve të kuvendeve zgjedhore. Duke u bazuar në nenin 15, pika 1 e rregullës zgjedhore për regjistrim dhe veprim të partive politike, prandaj secila parti e themeluar dhe e regjistruar ka obligim që brenda 48 muajve, ta mbaj kuvendin zgjedhor të radhës.

Në zyrë, kanë ardhur gjashtë kërkesa për shtyrjen e afateve, tha Selmani. Arsyetimi ka qenë për shkak të gjendjes pandemike dhe masat kufizuese. Bashkangjitur keni kërkesat, dhe raportin në këtë drejtim.

Florian Dushi, tha se në cilësinë e kryesuesit të këshillit për çështje ligjore, i kemi shqyrtuar kërkesat dhe, të gjitha, kanë pasur arsyetimin me rrethanat pandemike. Kërkesat, me vullnetin e subjekteve, kanë sjellë edhe datat se, kur ata mund t'i mbajnë kuvendet. Dhe se, sipas rregullës tonë, dhe se më së largu deri në tetë muaj, këto subjekte në ndërkohë, do ti mbajnë kuvendet.

Ne, i kemi konsideruar si të bazuara, dhe ne rekomandojmë që brenda afateve që vetë ato i kanë përcaktuar, të miratohen kërkesat.

Subjektet, janë: Aleanca Kosova e Re, Pokret za Zhupu i Diasporu Zhupska, Partia Liberale Egjiptiane, Forca e Diasporës, Partia Politike URA, dhe Lëvizja “Vetëvendosje!”.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e ZRPPP

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

1. Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të anëtarëve të Kuvendeve Komunale në: Viti dhe Deçan, Malishevë dhe Prizren:

Florian Dushi: Në mbledhjen e fundit, këshilli ka shqyrtuar disa kërkesa për zëvendësime të asambleistëve komunalë. E keni materialit. I kemi shqyrtuar, dhe miratuar. Pra, konsiderojmë se gjithëcka ka qenë në rregull, dhe ne si këshill i rekomandojmë KQZ –së për aprovim të këtyre zëvendësimeve.

Florian Dushi: Në komunën e Vitisë, e dorëhequra Majlinda Ostrogllava zëvendësohet nga Taibe Ibrahimini nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Deqanit, e dorëhequra Agnesa Vokshi, zëvendësohet nga Lulavere Selmanaj nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Malisheves, i dorëhequri Hajdin Berisha zëvendësohet nga Astrit Sertolli nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Malisheves, i dorëhequri Blerim Thaci, zëvendësohet nga Halil Morina nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Malisheves, i dorëhequri Bashkim Krasniqi zëvendësohet nga Hasim Rudi nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Malisheves, i dorëhequri Bashkim Krasniqi, zëvendësohet nga Hasim Rudi nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Malisheves, i dorëhequri Avdi Morina zëvendësohet nga Valon Mazreku nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Malisheves, e dorëhequra Besarta Ramaj zëvendësohet nga Gentiana Hoti nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Prizrenit, i dorëhequri Islam Ukaj zëvendësohet nga Bujar Hasani nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Prizrenit, i dorëhequri Sulltan Badalli, zëvendësohet nga Shkelzen Kastrati nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet...

4. Këshilli për Operacione Zgjedhore:

1.Shqyrtimi dhe miratimi i projektit: Dita globale e zgjedhjeve:

Alim Rama: Në mungesë të kryesuesit, e kam udhëhequr mbledhjen e këshillit. Së pari, kemi shqyrtuar shënimin e ditës globale të zgjedhjeve, e që do të jetë të enjten më 3 shkurt. Do të shënojmë aktivitet me, bashkë me akterët relevant të procesit zgjedhor. Nëpër komuna, do të shënohet në formë bashkëbisedimi me të rinjtë, kjo ditë...!

E keni përpara një raport. Ne, rekomandojmë aprovimin e kësaj agjende.

Diskutuan: Arianit Elshani.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i projektit dhe agjendës për punëtorinë: Raport mbi implementimin e planit të punës së KQZ-së i vitit 2021, dhe hartimi i planit të punës së KQZ-se për vitin 2022:

Në këtë pikë, fillimisht krye shefi Burim Ahmetaj, i njoftoi anëtarët e KQZ-së lidhur me qëllimin dhe objektivat e agjendës së punëtorisë.

Sami Kurteshi, pyeti rreth kohëzgjatjes së punëtorisë, dhe kundërshtoi që punëtorja të mbahet jashtë Kosovës. Alim Rama, tha se në mungesë të kuormit nuk është përfunduar kjo çështje në këshill, dhe ai e kundërshtoi kohëzgjatjen prej pesë ditësh. Ai, bëri vërejtje për përsëritje të specifikave, dhe kërkoi

që të ketë një propozim më të artikulaur. Arianit Elshani, u pajtua me vërejtjet e bëra dhe kërkoi që ky projekt, të rishikohet edhe njëherë! Po ashtu, edhe Kreshnik Radoniqi, tha se, projekti të kthehet edhe njëherë në këshillë dhe të trajtohet.

5.Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për punëtorinë: Raporti mbi implementimin e planit të punës së KQZ-së i vitit 2021, dhe hartimi i planit të punës se KQZ-se për vitin 2022:

Ilir Gashi, tha se këshilli është takuar dje, dhe se në mungesë të kryesuese, e kam udhëhequr unë takimin. Është shqyrtuar buxheti për punëtorinë. Buxhet ka që të organizohet kjo punëtori, dhe s'ka nevojë të silltet më në këshillin për buxhet. Pastaj, ka qenë edhe shqyrtimi dhe miratimi i planit përfundimtar i Prokurimit për vitin 2022.

Arianit Elshani, foli mbi edukimin dhe informimin e votuesve, në kontekst mbi aktivitetet e ardhshme në këtë drejtim, dhe se kjo çështje duhet trajtuar përgjatë planit të punës dhe në DOZ. Rreth planit të prokurimit, Ibrahim Selmanaj tha se çështja e sigurimit të automjeteve, nënkupton problemin se ato nuk janë në gjendje të mirë, dhe as të sigurta, dhe nuk mbikëqyren. Mjetet janë të parapara, dhe duhet me qenë më efikas në këtë drejtim.

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, nëse nuk ka tjetër, kush është për...?

Me dhjetë vota, miratohet.

Diskutim lidhur me vendimin e KQZ-së Nr.355/2021, të datës 30.01.2021, për pagesën e stafit të KQZ-së për rrezikshmërinë në punë nga pandemia COVID-19, lidhur me organizmin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës:

Ilir Gashi, tha se lidhur me një vendim të marrë në zgjedhjet e shkurtit 2021, ne kemi diskutuar dhe se, ky vendim të rikthehet dhe se nëse ekziston e drejta, njerëzit të paguhen. Nëse ai ligj është shfuqizuar, atëherë ne duhet të kemi parasysh se njerëzit duhet të kompensohen nëse janë paguar në shkurt, dhe nuk paguhen në tetor 2021. Unë, jam qe kjo që të shihet, sepse ne mund te kemi implikime, pra të shohim si është gjendja e këtij vendimi...

Ibrahim Selmanaj, tha se bëhet fjalë për kompensim. A mund të na shpjegoj dikush, pak më qartë në këtë drejtim ?

Burim Ahmetaj: Bëhet fjalë për rrezikshmërinë në punë, dhe se KQZ ka marrë vendim më 30 janar 2021, për shkak të masave pandemike, pra për shkak të rrezikshmërisë në punë, në këtë rast infektimi me covid! Pra, bëhet fjalë për pagesë mbi rrezikshmërinë në punë...

Kreshnik Radoniqi, tha se vendimi është, pra tash po diskutojmë a me u ekzekutue apo, jo...!

Sami Kurteshi, tha se, pajtohet me z. Gashi, por që fillimisht të shihet nëse kjo është në relacion edhe me vendimin e qeverisë, pra cilat janë ato vende të punës, cilat kanë qenë kontaktet etj. Por, edhe cilat janë arsyet që nuk është ekzekutuar ky vendim... Jam që të analizohet mirë, dhe mandej të vendosim... Vetëm në shihet në akseptin ligjorë, por edhe operativ...

Florian Dushi, tha se e kemi një vendim, dhe që fletë specifikisht! Si KQZ, fillimisht të vendosim si të veprojmë, sepse është në fuqi, dhe se dihet se pse është miratuar...! Vendimi është i zbatueshëm, dhe se, në rrethana të ngjashme është punuar, edhe në tetor... Por, të shihen aspektet ligjore...

Unë, tha z. Dushi, t'i shqyrtojmë çështjet, sepse kjo determinon edhe qëndrimet tona.

Arianit Elshani, tha se duket rekomandim i vonuar, por ndoshta Sekretariati nuk ka pasur as kohë, dhe se ky rekomandim, edhe është diskutuar në punëtori... Pajtohem me parafolësit: të shihet së pari, baza ligjore... Pa e shqyrtuar bazën ligjore, nuk kemi si të marrim vendim... E, nëse ka bazë ligjore, të shihen të gjitha specifikat, dhe të jemi objektiv...

Čemailj Kurtiši: Unë do të thosha vetëm se, pajtohem me një pjesë të mirë të diskutimeve. Por, nëse qeveria ka pas një vendim në këtë drejtim, çështjet nuk mund të jenë selektive! Nëse ka pasur rrezik diku tjetër, ka pasur edhe rrezik edhe në KQZ. Ne, jemi të obliguar tu rrimë si duhet vendimeve tona, dhe Sekretariati ta shqyrtojë këtë çështje, dhe ta përgatisë një propozim se për çka të votojmë, por diskriminim nuk duhet të ketë. Ka qenë edhe KQZ e rrezikuar, nëse të tjerët kanë qenë.

Ilir Gashi: Ky është vendim! Çështja është të kemi një informacion, nëse mund të ekzekutohet por, vendimi është. Nëse janë këto mundësi, unë jam të riformulohet vendimi, dhe të mos ketë diskriminim. Nëse nuk ka mundësi të ekzekutohet, të shfuqizohet...

Në vazhdim, përsëri folën mbi këtë pikë: Florian Dushi, Ibrahim Selmonaj, pastaj Fazli Stollaj i cili tha se, vendimi nuk është ekzekutuar për shkak të mungesës së buxhetit. Burim Ahmetaj tha se, ne kemi përcjellë më 5 shkurt 2021 kërkesën për buxhet shtesë mirëpo, qeveria nuk ka ndarë mjete. Miradije Meha, shpjegoi se në bazë të vendimit që ka marrë KQZ më 30 janar 2021, kërkesa jonë është bërë për buxhet shtesë në vlerë prej 57 600 euro, pra për 3 muaj, për stafin e KQZ.

Nuk kemi marrë përgjigje. Na kanë thanë se ju informojmë, por ata nuk na kanë informuar. Ne, s'kemi pasur buxhet, ndonëse më 8 shkurt, ne jemi drejtuar për buxhet shtesë... Më 14 gusht 2020, qeveria ka pasur një vendim, në këtë drejtim...

Alim Rama, tha se, ne duhet shfuqizuar këtë vendim sepse, ne s'kemi qenë institucion i veçantë, dhe mendojë se jemi para aktit të kryer... Sami Kurteshi, tha se, megjithatë Sekretariati të na vijë në mbledhjen e ardhshme me informatë konkrete...

Kreshnik Radoniqi, tha se nëse bën, ta shtyjme në mbledhjen e ardhshme...

6.Këshilli i Personelit

Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshimit të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2012, për emërimin dhe shkarkimin e KE/ZV/SKQZ, Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së dhe Zëdhënësit për Informim, adt.19.03.2012:

Alim Rama: Lidhur me plotësimin e vendeve vakante, ne kemi shqyrtuar këtë pikë dhe se, materialin e keni përpara. Z. Rama, shpjegoi çështjet procedurale ligjore, kushtet, dhe specifikat e tjera që lidhen me harmonizimin e rregullore, s'i dhe procedurat lidhur me kushtet e procedimit të konkursit, si përbërja e panelit...

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka askush diçka, kush është për miratim ?

Me 9 vota për, dhe 1 votë abstenim (Florian Dushi), miratohet.

Diskutim lidhur me pajisjen me ID-kartelet VIP për anëtarët e KQZ-së:

Alim Rama: Lidhur me këtë pikë, Sekretariati ka kërkuar një vendim të KQZ –së s'i bazë për t'ju referuar institucioneve përkatëse...

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Florian Dushi, Kreshnik Radoniqi, pastaj Vahide Behrami nga departamenti i Personelit, Burim Ahmetaj, Arianit Elshani.

7. Të ndryshme !

Për KQZ

Kreshnik Radoniqi, kryetar
